

**AKT THEMELIMI I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“QUICK LOANS” SHPK**

Bazuar ne Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregëtare”, i ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr.129/2014, datë 02.10.2014 dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, liçensimit, dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, sot në Tiranë, më datë 03.02.2020

**Z. Elvis Mataj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 05.01.1977, me letërnjoftim me nr. Personal H70105166A, banues në Rr “Muhamet Gjollësja”, P.58, Shk.2, Ap.20, Tiranë (në vijim “**Ortaku i Vetëm**”), i cili ka themeluar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të të drejtës shqiptare, të emëruar “**QUICK LOANS**” SHPK, e përshkruar më poshtë, ku zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë, dhe aktiviteti i të cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

**Neni 1**

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**QUICK LOANS**” SHPK (“Shoqëria”). Administratori i Shoqërisë është **Z. Elvis Mataj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 05.01.1977, me letërnjoftim me nr. Personal H70105166A.

**Neni 2**

Nga momenti i regjistrimit në regjistrin tregtar të shoqërive (Q.K.B.), shoqëria gëzon statusin e personit juridik të të drejtës shqiptare. Aktiviteti i saj do të ushtrohet sipas këtij akti themelimi, statutit, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregëtare”, i ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr.129/2014, datë 02.10.2014 dhe ligjeve në fuqi.

Selia e Shoqërisë ndodhet në: **Rruga “Frang Bardhi”, Pallati i Qendrës Kristal, Hyrja nr.1, Apartamenti nr. 18, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë, Shqipëri**. Selia mund të zhvendoset në çfarëdo adresë tjetër me vendim të thjeshtë të organit administrativ (administratorit), që ka të drejtë të kryej më pas regjistrimet përkatëse në regjistrin tregtar.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do ta gjykojë të nevojshme me anë të një vendimi të organit administrativ.

Statuti i Shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.

**Neni 3**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohë të pakufizuar.

Shoqëria mund të shpërbëhet më parë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 4**

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve si më poshtë:

Ushtrimi i aktivitetit si Institucion Financiar i Mikrokredisë në të gjitha format e saj, duke përfshirë shërbime këshilluese për veprimtarinë e kredidhënies, si dhe blerje të kredive të portofoleve të mikrokredisë me vonesë.



Shoqëria mund të lidhe marrëveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshem me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi

#### **Neni 5**

Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) Lekë, i nënshkruar në të holla nga Ortaku i Vetëm që i korrespondon 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë të nënshkruar dhe të shlyer plotësisht me vlerë totale prej 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) Lekë.

#### **Neni 6**

Fitimi neto që do të rrjedhë nga veprimtaria e Shoqërisë dhe nga pasqyrat financiare vjetore i përket ortakut të vetëm.

#### **Neni 7**

Për detyrimet ndaj të tretëve që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj. Përgjegjësia e ortakëve kufizohet në kontributet e nënshkruara.

#### **Neni 8**

Dispozita më të hollësishme për organizimin e kësaj Shoqërie përcaktohen në Statut.

#### **Neni 9**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (*katër*) kopje në gjuhën shqipe

**Ortaku i Vetëm**

**Z. Elvis Mataj**

